

Mundësi për aplikim të bashkive në thirrjen “Networks of Towns” CERV-2025-CITIZENS-TOWN-NT nën Programin CERV

Synimi i Thirrjes:

Kjo thirrje synon të promovojë shkëmbimet ndërmjet qytetarëve nga vende të ndryshme për të ndarë praktikatat e mira dhe për të rritur përfshirjen e qytetarëve në jetën demokratike të Bashkimit Evropian. Thirrja nxit krijimin e rrjeteve të qëndrueshme të qyteteve për të thelluar bashkëpunimin dhe për të zhvilluar vizion afatgjatë për integrimin evropian.

Fushat e veprimit të thirrjes:

- Bashkimi i qytetarëve për të diskutuar dhe për të ndarë praktikatat e mira, duke ndihmuar kështu në rritjen e angazhimit të qytetarëve në shoqëri dhe në proceset demokratike;
- Promovimi i ndërgjegjësimit dhe krijimi i njohurive për të drejtat e qytetarisë së BE-së, lëvizjen e lirë të njerëzve, vlerat e përbashkëta evropiane, si dhe standardet e përbashkëta demokratike, duke i bërë ato më të prekshme për qytetarët e BE-së;
- Identifikimi i mënyrave për të forcuar më tej dimensionin evropian dhe legjitimitetin demokratik të procesit vendimmarrës të BE-së dhe nxitjen e qeverisjes demokratike të lirë, të hapur dhe të shëndetshme në një epokë të pjesëmarrjes së ulët në zgjedhje, populizmit, dezinformimit dhe sfidave me të cilat përballet shoqëria civile, duke përfshirë mbështetjen e pjesëmarrja aktive e qytetarëve, duke përfshirë fëmijët, dhe organizatat e shoqërisë civile në politikëbërjen në nivel lokal, kombëtar dhe evropian;
- Promovimi i ndërgjegjësimit, ndërtimi i njohurive dhe shkëmbimi i praktikave të mira mbi përfitimet e diversitetit, si dhe masat efektive se si të trajtohet diskriminimi dhe racizmi në nivel lokal;
- Nxitja e ndërgjegjësimit dhe krijimi i njohurive për rolin e minoriteteve, të tilla si njerëzit me një prejardhje racore ose etnike të pakicës (për shembull romët dhe migrantët), në shoqërinë evropiane dhe kontributi i tyre në zhvillimin kulturor të Evropës;
- Promovimi i masave parandaluese dhe ndërgjegjësimit, shkëmbimi i politikave të praktikave më të mira që synojnë të frenojnë dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën ndaj fëmijëve në nivel lokal, si dhe bullizmin;
- Projektet mund të nxisin gjithashtu ndërgjegjësimin për rëndësinë e pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve përmes aktiviteteve kulturore, duke përfshirë frymëzimin ose duke u lidhur me iniciativën e re evropiane Bauhaus.

Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:

- Aplikuesit duhet të jenë bashki nga vendet e BE-së ose vendet e lidhura me programin CERV, ku Shqipëria bën pjesë.
- Çdo konsorcium duhet të përbëhet nga të paktën **4 aplikantë** nga vende të ndryshme, ku të paktën **dy prej tyre** janë shtete anëtare të BE-së.
- Aktivitetet duhet të zhvillohen në të paktën **dy vende të ndryshme të pranueshme**.

Aktivitete të pranueshme:

- Seminare, workshope, konferenca, aktivitete trajnuese, takime ekspertësh, webinare, aktivitete ndërgjegjësuese, evente me shikueshmëri të lartë, grumbullime dhe konsultime të dhënash, shkëmbime dhe shpërndarje të praktikave të mira ndërmjet autoriteteve publike dhe organizatave të shoqërisë civile, krijim i mjeteve të komunikimit dhe përdorimit të mediave sociale.
- Bashkitë ose qarqet dhe shoqatat që punojnë së bashku afatgjatë ftohen të zhvillojnë rrjete qytetesh për ta bërë bashkëpunimin e tyre më të qëndrueshëm dhe për të shkëmbyer praktikatat e mira.

- Rrjetet e qyteteve pritet të integrojnë një sërë aktivitetesh rreth temave me interes të përbashkët që lidhen me objektivat e programit, të përfshijnë anëtarët e komunitetit dhe të synojnë qëndrueshmërinë.
- Perspektiva e barazisë gjinore duhet të merret parasysh gjatë hartimit të "formatit" të aktiviteve, për të siguruar që ai të jetë i aksesueshëm për gratë dhe burrat në kushte të barabarta, si dhe gratë dhe burrat janë në gjendje të marrin pjesë në aktivite.
- Hartimi dhe zbatimi i projekteve pritet të promovojë barazinë gjinore dhe integrimin e jodiskriminimit. Për shembull, aplikantët mund të kryejnë dhe përfshijnë në propozimin e tyre një analizë gjinore, e cila do të hartonte ndikimin e ndryshëm që projekti dhe aktivitetet e tij mund të kenë potencialisht tek gratë dhe burrat, si dhe te vajzat dhe djemtë në të gjithë diversitetin e tyre. Për këtë qëllim, aplikantët inkurajohen të konsultojnë pyetjet kryesore të listuara në faqen e internetit të EIGE kur kryejnë analizën e tyre gjinore. Kjo analizë mund të ndihmojë në shmangien e ndonjë efekti negativ të paqëllimshëm të ndërhyrjes në secilën gjini (qasja “no-harm”).
- Aplikantët pritet të hartojnë dhe zbatojnë aktivitetet e tyre të komunikimit dhe shpërndarjes në një mënyrë të ndjeshme ndaj gjinisë. Kjo përfshin, në veçanti, përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore. E njëjta gjë vlen edhe për hartimin dhe zbatimin e aktiviteve të monitorimit dhe vlerësimit. Propozimet që integrojnë një perspektivë gjinore në të gjitha aktivitetet e tyre do të konsiderohen të cilësisë më të lartë.

Përiudha e zbatimit të projekteve

Projektet duhet të zhvillohen brenda periudhës nga 12 deri në 24 muaj (zgjatjet e periudhës së zbatimit të projekteve janë të mundshme, nëse janë të justifikueshme).

Cili është buxheti i thirrjes për secilën bashki:

Buxheti minimal për një projekt është **100,000 EUR**, pa kufi maksimal. Thirrja ka një buxhet të përgjithshëm prej **10 milionë EUR**, të cilat do të shpërndahen bazuar në projektet e miratuara.

Si bëhet aplikimi:

Aplikimi bëhet online përmes sistemit të Komisionit Evropian Funding & Tenders Portal dhe duhet të përfshijë:

- Pjesën administrative (Part A);
- Përshkrimin teknik të projektit (Part B);
- KPI me të dhëna shtesë të projektit dhe kontributin e projektit në treguesit kryesorë të performancës së programit të BE-së për t'u plotësuar direkt në sistem;
- **Shtojca të detyrueshme dhe dokumente mbështetëse** (shabllone të disponueshëm për t'u shkarkuar nga Sistemi i Parashtrimit të Portalit, të plotësuar, mbledhur dhe ringarkuar);
- Llogaritësi i shumës së përgjithshme;
- Lista e projekteve të mëparshme (projektet kryesore për 4 vitet e fundit) (model i disponueshëm në Pjesën B). Nuk zbatohet për organizatat e sapokrijuara;
- Një letër mbështetëse e nënshkruar nga një bashki (e aplikueshme për organizata jo fitimprurëse private që përfaqëson një autoritet vendor). Dokumenti duhet të sigurohet më së voni gjatë fazës GAP;
- CV-të (standarde) të ekipit kryesor të projektit: vetëm për organizata private jofitimprurëse (nën anekset e tjera);
- Raportet e aktivitetit të aplikantëve të vitit të kaluar: vetëm për organizata private jofitimprurëse. Nuk zbatohet për organizatat e sapokrijuara (nën anekset e tjera).
- Për të gjithë pjesëmarrësit që zbatojnë aktivite që përfshijnë fëmijë (nën moshën 18 vjeç):

- entet private duhet të dorëzojnë politikën e tyre të mbrojtjes së fëmijëve që mbulon katër fushat e përshkruara në Standardet e ruajtjes së fëmijëve të sigurt për fëmijët (shih seksionin 6 Etika dhe vlerat e BE-së)
- entet publike duhet të dorëzojnë në fazën e GAP një deklaratë nderi për respektimin e kërkesave për mbrojtjen e fëmijëve (model që do të ofrohet nga EACEA për projektet e ftuara në GAP) (shih seksionin 6 Etika dhe vlerat e BE-së).

Kur është afati i fundit:

Thirrja hapet më 17 dhjetor 2024 dhe afati i fundit për aplikim është më **27 mars 2025, ora 17:00 (ora e Brukselit).**

Linku i Thirrjes:

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/CERV-2025-CITIZENS-TOWN-NT?isExactMatch=true&status=31094501,31094502&frameworkProgramme=43251589&order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=startDate>